



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201152/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: Rekomandohet marrja e masave për parandalimin e rasteve të vetëvarjeve të të burgosurve.

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

TIRANË

INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

DURRËS

Të nderuar,

Në datën 18.07.2022, në media është bërë publik lajmi, se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, një i burgosur i ka dhënë fund jetës duke u vetëvarur në qeli. Viktima ishte i burgosuri Rolant Hasani, 44 vjeç, i cili ishte dënuar me 14 vjet burg për veprën penale "vrasje e mbetur në tentativë". Sipas mediave i dënuari vuante nga probleme të shëndetit mendor. Gjithashtu, në media u raportua se në dhomë me të burgosurin ka qenë edhe një i dënuar tjetër, por në ato momente, ai ka qenë në gjumë¹.

Me marrjen dijeni të këtij lajmi, Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, ngriti grupin e punës, me qëllim verifikimin e situatës në vend, si dhe intervistimin e bashkëvuajtësve dhe të stafit të IEVP Durrës, në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në këtë institucion.

Për të kuptuar nëse kjo ngjarje mund të parandalohet janë kryer veprimet hetimore si vijon: marrja e shpjegimeve nga i burgosuri, shok dhome me Rolant Hasanin dhe nga të burgosurit që e kanë gjetur atë të vetëvarur; këqyrja e vendit ku i dënuari Rolant Hasani ka varur veten; këqyrja e regjistrit të aktivitetit 24-orësh, të hyrje-daljeve të të burgosurve, të personelit dhe të librit të lënies së detyrave në seksionin ku ka ndodhur ngjarja; këqyrja e

¹ <https://www.balkanweb.com/detajet-u-vetevar-ne-qeline-e-burgut-ne-durres-44-vjecari-i-denuar-per-vrasje-mberriti-i-pajete-ne-spital-emri/>

regjistrit të terapisë mjekësore; këqyrja e dosjes psiko-sociale të të burgosurit Rolant Hasani; marrja e informacionit për organikën e stafit shëndetësor dhe social, si dhe administrimin e akt-ekspertimit nr.6658814 prot, datë 29.09.2022.

Sipas materialit të mbledhur rezulton se, i vetmi episod që mund të shërbente si tregues për personelin e I EVP Durrës, është se i dënuari Rolant Hasani shfaqte shenja të një rreziku për vetëvrasje, ka qenë ai i regjistruar në datën 18.07.2022, ora 12:48, kur Rolanti është parë nga punonjësi i policisë në dritare, se nuk po lëvizte. I dënuari vuante dënimin në dhomën 17 të godinës A, sektori 2, kati 2, bashkë me të cilin vuante dënimin e tij edhe i burgosuri tjetër Hysen Shera. Shoku i dhomës së Rolantit, gjatë intervistimit na bëri me dije se pasi janë zgjuar në mëngjes, kanë ngrënë mëngjes dhe kanë pirë kafe me të dënuarin Rolant Hasani. Ai ka dalë me pas në ajrim sipas orareve të afishuara nga institucioni. Gjatë konsumimit të kafes, në muhabet e sipër i dënuari Rolant Hasani me shaka i ka thënë se do vetëvritet, pasi nuk po i vinin prindërit për ta takuar. Më tej, ai tregoi se për rreth gjysmë ore ata kanë qëndruar duke bërë muhabet. Më pas i dënuari Hysen Shera është shtrirë përsëri për gjumë, dhe nuk ka qenë në dijeni se çfarë ka ndodhur më pas, deri kur kanë ardhur punonjësit e policisë dhe kanë parë të burgosurin të lidhur në dritare me një lidhëse këpucësh.

Ky rast tregon se, një shqetësim psikologjik në dukje i parëndësishëm, si luhatje humori, apati etj., mund të shërbejë si informacion për personelin e burgut për të kuptuar se kemi të bëjmë me një rrezik të shtuar vetëvrasje. Punonjësit e policisë, që përbëjnë frontin e parë të parandalimit të vetëvrasjeve, duhet të informojnë për çdo episod, jo vetëm personelin shëndetësor, por edhe atë social, të cilët sa më parë duhet të marrin takim me të dënuarin që paraqet rrezik potencial. Gjithashtu, duhet të lihen detyra për personelin e sektorit policor që të vëzhgojnë të dënuarin gjatë veprimeve të tij në ambientet që nuk monitorohen nga kamerat, të paktën për disa ditë pas regjistrimit të episodit.

Nga mbikëqyrja e ambientit të dhomës nr.17, ku i burgosuri kishte kryer vetëvrasjen, e cila ishte me sipërfaqe 4m², dritarja e kësaj dhome ishte me përmasa të mjaftueshme dhe mundësonte futjen e sasisë së konsiderueshme të ajrit dhe të dritës natyrale. Nga vlerësimi i kushteve materiale të institucionit, ato nuk janë sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m² për dhomat për një person dhe 4 m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2 m distancë, dhe jo më pak se 2.5 m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës, sikurse përcaktohet dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Sipas konstatimeve, në dritare kishte lidhëse ose litarë të shkurtër të cilët shërbenin për tharje rrobash, edhe pse nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandime të përsëritura për marrjen e masave për të hequr nëpër dritaret e dhomave të të burgosurve këto lidhëse dhe litarë, pasi mund të jenë në çdo kohë iniciativë për vetëdëmtim nga të burgosurit. Gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar edhe marrjen e masave për krijimin e një vendi të caktuar për tharjen e rrobave të të burgosurve, por ky rekomandim nuk është zbatuar nga institucionet e I EVP-ve.

Nga kqyrja akt ekspertimit nr. 66584 prot, nr.299 Regj datë 29.08.2022, për shtetasin Roland Hyseni, ndër tjera thuhet se “Në trupin e shtetasit Roland Hyseni u konstatua brazë strangulimi e njëfishtë dhe e pjerrët, maviosje e fytyrës, piketime hemoragjike në indet e buta dhe muskujt e qafës, thyrje e kockave të laringut, si dhe stazë e organeve në pergjithësi. U konstatuan gërvishtje dhe mbetje plagësh të moshave të ndryshme të lokalizuara në ftyrë, qafë gjoks dhe gjymtyre e poshtme”. Sipas akt ekspertimit, vdekja e shtetasit Roland Hyseni ka ardhur nga asfiksia mekanike si pasojë e shtrengimit të qafës me lak nëpërmjet peshës së trupit.

Në përfundim të hetimit të kryer në IEVP Durrës, nga administrimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës në lidhje me ngjarjen e ndodhur në ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, si dhe nga informacioni i dhënë nga drejtuesit e këtij institucioni, konstatohet se:

- ✚ Nga këqyrja e kartelës shëndetësore, i dënuari Rolant Hasani vuante nga probleme të shëndetit mendor. Lidhur me këtë problematikë konstajmë se nuk kemi referim për ndjekjen e rastit të burgosurit dhe as ndonjë trajtim të veçantë apo referim tek mjeku specialist.
- ✚ Nga mbikëqyrja rezulton se në dhomën nr.17 të godinës A, sektori 2, kati 2, i dënuari Rolant Hasani, me anë të një lidhëseje këpucësh të gjatë 1m e 30 cm, e ka vendosur atë në dritare, ku në njërin anë kishte një gogël dhe dyshohet se është vetëmbytur. Kjo tregon se punonjësit e policisë së burgjeve nuk kanë treguar kujdes ndaj të dënuarit për kontrollin e imët dhe të rregullt të kryer ndaj tij, sipas procedurave standarde ligjore dhe akteve nënligjore.
- ✚ Mungesa në organikën e stafit mjekësor nuk garanton një shërbim shëndetësor cilësor për të burgosurit, në mënyrë që të garantojnë ruajtjen e shëndetit të personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim. Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t’i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda, ashtu siç ishte rasti konkret.
- ✚ Për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon sektorit shëndetësor dhe përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon. Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012 “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar ku thuhet se: "Ekipet multidisiplinare" janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi apo specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor².
- ✚ Konstatohet se nuk është garantuar akomodimi i të dënuarve dhe të burgosurve në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në

²Pika 4 e nenit 3, të Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”.

institucione të tilla, që janë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² për person, kur në to sistemohen më shumë banorë.

- ✚ Mungesa e pajisjes së institucionit me një autoambulancë dhe transportimit të të burgosurve me automjetin e institucionit, sjell mosofrim në çast të shërbimit shëndetësor dhe në rastin mos dhënies e ndihmës së parë ndaj të burgosurit.

Në ligjin nr.81/2020 datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në nenin 42, pika 2 përcaktohet se trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor sigurohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor. I burgosuri që gjendet në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe që ka çrregullime të shëndetit mendor, gëzon të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor, pranë strukturave shëndetësore të specializuara për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit. Trajtimi shëndetësor i të burgosurve, përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontrollet për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, sëmundjet e lindura të gjakut, kujdesin shëndetësor mendor, çrregullimet posttraumatike, rrezikun e vetëvrasjes ose të vetëdëmtimit etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar i kërkon në mënyrë të përsëritur Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, plotësimin e stafit psiko-social sipas ligjit dhe akteve ligjore në fuqi, si dhe ofrimin e shërbimit psiko-social nga ana punonjësve të edukimit, duke ofruar asistencën e tyre çdo ditë me frekuencë 4 orë, nëpërmjet bisedave dhe aktiviteteve me të burgosurit. Kjo do të krijonte një klimë të sigurt që ushqen besim reciprok, u krijojnë të dy palëve në komunikim të ndiejnë përgjegjësi, u ofron më shumë liri zgjedhjeje dhe si rezultat u mëson të kenë më shumë aftësi sociale. Gjatë gjithë kohës, nga ana e stafit të kujdesit social duhet të zhvillohen tema të ndryshme për të përballuar presionin e grupit, për të përvetësuar aftësitë dhe për t’u përshtatur me jetën e re sociale. Nga ana e psikologëve të institucionit duhet të zhvillohen biseda këshilluese çdo ditë, sidomos me personat që paraqesin probleme psikologjike, si dhe ata të cilët kanë probleme me përshtatjen me rregullat dhe kushtet e burgut. Mungesa e stafit mjekësor në këtë institucion ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit mjekësor, pasi mund të ketë raste urgjente, të cilat personeli shëndetësor nuk mund t’i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku punon me kohë të pjesshme dhe është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës, përbën cënim të standardeve të kujdesit shëndetësor. *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor, në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”;* të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas*

tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive, si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Analizimin me hollësi të rastit nga strukturat kompetente të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për punonjësit e Policisë së Burgjeve, të sektorit psiko-social dhe atij shëndetësor në IEVP Durrës, në objekt të këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësiave përkatëse, në funksion të një sjelljeje korrekte të ofrimit cilësor të shërbimit dhe të trajtimit të të burgosurve sipas ligjit.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e stafit të sektorit shëndetësor për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, si dhe duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë të dënuarit, higjienës vetjake të tyre, si dhe mjedisit që i rrethon. Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012, “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar.
3. Marrjen e masave të nevojshme për të garantuar akomodimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person.
4. Analizimin e këtij rasti dhe përgjithësimin i tij në të gjitha IEVP-të, në mënyrë që personeli policor, shëndetësor dhe ai social të vlerësojë më saktë rrezikun për vetëvrasje që paraqet një i burgosur.
5. Nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të ushtrohet më shumë dhe më mirë kontroll në IEVP-të, lidhur me zbatimin e akteve normative ligjore e nënligjore për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të rekomandimeve të herë pas herëshme të Avokatit të Popullit, të cilat janë vlerësuar e mirëpritur nga organi juaj.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI